

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke vlerësuar se ndryshimet e fundit në ligjin e medias e për afrojnë më tej këtë ligj me standardet e BE-së duke u fokusuar në forcimin e transparencës së pronësisë së mediave dhe të financimit të mediave përmes fondeve publike të alokuara për reklamat shtetërore dhe shumës totale vjetore të të ardhurave nga reklamat të përfituara nga autoritetet publike ose nga entitete të vendeve të treta;

Duke theksuar nxitjen dhe mbështetjen e standardeve profesionale të transmetimeve audiovizive përmes praktikave më të mira ndërkombëtare;

Shqyrtoi veprimtarinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2025 dhe vlerëson:

Kontributin për ndryshimet në ligjin e medias, të cilat e për afrojnë këtë ligj me standardet e BE-së duke u fokusuar në forcimin e transparencës së pronësisë së mediave dhe të financimit të mediave përmes fondeve publike të alokuara për reklamat shtetërore dhe shumës totale vjetore të të ardhurave nga reklamat të përfituara nga autoritetet publike ose nga entitete të vendeve të treta.

Punën e bërë në fushën e edukimit mediatik, si një investim afatgjatë dhe një nga prioritetet e punës së AMA-s dhe në njëjtën kohë si një instrument kryesor parandalues për mbrojtjen e interesit publik, dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, veçanërisht të të rinjve dhe fëmijëve ndaj rreziqeve të mjedisit audioviziv dhe digjital.

Bashkëpunimin e AMA-s me rrjetin X, një nga platformat e mëdha *online*, për të mbikëqyrur dhe ndjekur me prioritet çdo përmbajtje të dëmshme në gjuhën shqipe, ku shfaqet apo nxitet dhunë e çdo lloji, me gjuhë urrejtje, përmbajtje që shkelin të drejtat e fëmijëve dhe komuniteteve, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut etj.

Ekspertizën e specializuar të ofruar nga AMA në kuadër të Platformës së Dialogut, si mekanizëm konsultimi dhe bashkëpunimi me ekspertë dhe aktorë të sektorit të medias për paketën e ndryshimeve të nevojshme në ligjin e medias dhe për afrimin e tij me standardet e kërkuara nga BE-ja.

Punën e bërë për respektimin e të drejtave të transmetimit, veçanërisht monitorimin e rrjeteve *online*, duke identifikuar dhe bllokuar një sërë rastesh të përdorimit të serverave të ndryshëm që përdoreshin për shpërndarjen dhe shitjen e produkteve audiovizive në mënyrë pirate.

Punën e bërë përmes aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere me nxënës të shkollave të mesme, duke e shtrirë këtë program jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethe. Këto aktivitete lidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve në mjedisin mediatik dhe digjital për një mjedis të pastër, pa dhunë e urrejtje.

Nënshkrimin e dy marrëveshjeve të bashkëpunimit nga AMA përkatësisht me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, e cila ka për qëllim të parandalojë shkeljen e të drejtave të transmetimit dhe të ndihmojë në ndërgjegjësimin për respektimin e të drejtës së autorit, dhe me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, e cila synon forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve për marrjen e masave me qëllim rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit në sektorin e mediave audiovizive, që lidhen me kushtet e punës, mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, pagat, sigurimet dhe mirëqenien në punë.

Punën e bërë për implementimin e programit *software* të dedikuar për Regjistrin e Monitorimit dhe Analizimit të të Dhënave si një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të proceseve të mbledhjes, administrimit dhe analizimit të të dhënave për tregun audioviziv dhe rritjes së efektivitetit të punës së institucionit.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Autoriteti i Mediave Audiovizive për vitin 2026 në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Me ndryshimet e reja ligjore të ketë prioritet të punës së saj gjatë vitit në vijim implementimin e databazës kombëtare të pronësisë mediatike, që përmban informacionin e përcaktuar në nenin 33/1 të ligjit nr. 15/2026 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2013 ‘Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë’”, i ndryshuar.

2. Të vijojë të japë kontribut konkret në ndryshimet e pritshme ligjore në paketën e medias, ndryshime të cilat synojnë përafrimin e legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Evropian.

3. Të implementojë në faqen kryesore zyrtare seksionin “Për persona me aftësi të kufizuara”, pjesë e të cilit të jetë edhe një formular i thjeshtuar kontakti ku përfshihen informacione mbi të drejtat e aksesit dhe shërbimet publike të AMA-s, kontaktin e personit të caktuar brenda institucionit për trajtimin e kërkesave, ankesave dhe asistencës ndaj kësaj kategorie, informacione praktike për përdorimin e mjeteve të aksesueshmërisë në faqen zyrtare, në mënyrë që të garantojë një qasje të barabartë në informacion, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

4. Me qëllim përmbushjen e standardeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për aksesueshmërinë digjitale, si dhe rritjen e transparencës dhe qasjes së barabartë në informacion publik, të ndërmarrë një proces të standardizimit të strukturës vizuale dhe funksionale të faqes zyrtare, i cili do të përfshijë unifikimin e menusë së navigimit dhe strukturës së informacionit, harmonizimin e dizajnit grafik në të gjitha faqet dhe nënfaqet, integrimin e funksioneve të aksesueshmërisë në çdo seksion të faqes, optimizimin e kodimit të faqes për pajtueshmëri me lexues automatikë dhe teknologji asistive (*screen readers*).

5. Rritja e numrit të ankesave (me afro 24% nga viti i kaluar) tregon nga njëra anë rritjen e ndjeshmërisë së opinionit publik lidhur me përmbajtjet që mediat audiovizive transmetojnë, rritjen e besueshmërisë së publikut tek AMA, por në të njëjtën kohë është edhe tregues për domosdoshmërinë e zhvillimit të mëtejshëm të procesit të edukimit mediatik, me synim forcimin e audiencave në mirinformim, vendimmarrje dhe mbrojtjen nga fenomenet negative dhe përmbajtjeve të dëmshme në transmetimet audiovizive.

6. Të vlerësohen mundësitë teknike, operacionale dhe financiare për ngritjen dhe funksionalizimin gradual të një Studioje Monitorimi në AMA, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e përmbajtjeve mediatike, në përputhje me prioritetet strategjike dhe mundësitë buxhetore të institucionit.

7. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performacës si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda tremujorit të tretë të këtij viti.

8. Të forcojë dhe institucionalizojë bashkëpunimin ndërinstitutional me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Prokurorinë e Përgjithshme, Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e të Drejtës së Autorit dhe Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut përmes nënshkrimit të një memorandumi bashkëpunimi, me qëllim rritjen e koordinimit për parandalimin dhe luftën kundër piraterisë digjitale, mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe forcimin e sigurisë në hapësirën digjitale. Brenda 30 ditëve nga miratimi i kësaj rezolute, të informojë Kuvendin për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi.

Miratuar në datën 16.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi